



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:065936

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05819478

KPPP.nr. 934/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Incod” NNP, me seli në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani, kundër debitorit NT “Molika”, me numër unik identifikues 810397340 dhe seli në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Gazmend Nushi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 369/23, të lejuar me datë 07.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 13.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit NT “Molika”, me seli në Pejë, i paraqitur ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 369/23, të lejuar me datë 07.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 369/23, të lejuar me datë 07.06.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, MBETET NË FUQI.
- III. DETYROHET debitori NT “Molika” që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguajë kreditorit “Incod” NNP, shumën në lartësi prej EUR 312.00 (treqind e dymbëdhjetë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të “Incod” NNP, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 662/21, të datës 23.02.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 369/23, të datës 07.06.2023, me të cilin ka urdhëruar debitorin NT “Molika”, që në emër të përmbushjes së obligimeve sipas

aktgjykimit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 13,065.46, me kamatë ligjore prej 8 % në vit duke filluar nga data 27.09.2017 e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej EUR 2,921.62, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbare në shumë prej EUR 312.00.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbare me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marrë vendimi përmbare ose urdhri përmbare nuk ka tipare të përmbareshmërisë. Më tej, ka theksuar se propozimi për përmbare nuk përmban numrin e regjistrimit të debitorit dhe rrjedhimisht organi përmbare ka qenë i detyruar që kreditorit t'ia kthej propozimin në plotësim. Ndërsa, ka shtuar se debitori ka paraqitur edhe revizion pranë Gjykatës Supreme për të cilin ende nuk është vendosur. Në fund, ka theksuar se realizmi i kredisë është shuar për shkak se debitori si shoqëri tregtare është shuar me c 'rast ka pushuar së ekzistuari. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbare të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim të paraqitur përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka theksuar se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbare, respektivisht Aktgjykimi I.EK.nr. 662/21, i datës 23.02.2022 ka tiparet e dokumentit përmbare, i njëjti është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. Më tej, ka theksuar se sa i përket pretendimit të debitorit për mos paraqitjen e numrit të biznesit të debitorit, numri i biznesit tashmë është i ditur, duke qenë se ndaj tij është zhvilluar procedura kontestimore. Tutje, ka shtuar se paraqitja e revizionit ndaj aktgjykimi të shkallës së dytë, nuk e bën dokumentin përmbare pa tipare të përmbareshmërisë. Poashtu, ka theksuar se debitori ka shuar biznesin e tij me qëllim të ikjes nga detyrimi për pagesën e borxhit ndaj kreditorit, duke qenë se biznesi individual "M.A. B.I", me emër tregtar "Molika", përkundër ekzistimit apo jo të biznesit individual nuk e liron M.A. si person fizik nga detyrimi i tij ndaj kreditorit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbare të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbare, për përpilimin e propozimit për përmbare në shumë prej EUR 312.00, si dhe për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumë prej EUR 312.00.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbare, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas dokumentit përmbareues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 662/21, të datës 23.02.2022, është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit NNP “Incod, këtu kreditorit, ku është detyruar i padituri NT “Molika”, këtu debitori, që t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 13,065.46, me kamatë ligjore prej 8 % në vit duke filluar nga data 27.09.2017 e deri në pagesën definitive, si shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej EUR 2,921.62, në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se organi përmbareues ka lejuar përmbarrimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarrimor, përkatësisht aktgjykimin në bazë të së cilit përmbareuesi privat ka lejuar përmbarrimin dhe gjeti si i njëjti, në kuptim të nenit 22 paragrafit 1, pika 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbareues mbi bazën e të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu, gjykata gjeti se aktgjykimi në fjalë i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata vlerëson aktgjykimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarrimor i plotëson kushtet sipas nenit 36, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbareues i dorëzohet edhe dokumenti përmbareues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbareueshmëris për përmbareueshmëri”,* ngase i njëjti është bërë i plotfuqishëm më datë 30.03.2023 dhe i ekzekutueshëm me datë 06.06.2023.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit se propozimi për përmbarrim përmban të meta për shkak se nuk është treguar numri i biznesit të debitorit, mirëpo të njetjat i gjeti si të pabazuara ngase kreditori së bashku me propozim për përmbarrim ka paraqitur edhe të dhënat për debitorin të gjeneruara nga faqja zyrtare e ARBK-së, ku përfshihet këtu edhe numrin unik identifikues, dhe rrjedhimisht si për organin përmbareues edhe për gjykatën debitori është i identifikueshëm dhe se propozimi për përmbarrim nuk ka përmbajtur të meta në kuptim të nenit 30 të LPP-së.

Poashtu, gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se i njehti si shoqëri tregtare është shuar me datë 24.10.2022 dhe rrjedhimisht është shuar edhe kredia lëndorë, mirëpo të njetjat pretendimet i gjeti si të pabazuara nga fakti se debitori ka qenë i regjistruar si shoqëri tregtare në formën e biznesit individual dhe në kuptim të nenit 48 të Ligjit për shoqëritë tregtare pronari i biznesit individual ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të biznesit individual, dhe rrjedhimisht shuarja e biznesit individual nuk e liron pronarin e saj nga detyrimet e krijuara të shoqërisë i cili përgjigjet më tërë pasurinë e tij.

Në fund gjykata pati parasysh edhe faktin se debitori ka paraqitur revizion pranë Gjykatës Supreme, mirëpo vlerësoj se revizioni i paraqitur nuk është pengesë për ekzekutimin e aktgjykimit objekt përmbartimi, kjo në kuptim të nenit 213 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me të cilin përcaktohet se *“Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbartimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”*.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbartimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Ndërsa, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet, gjykata vendosi si në piken III të dispozitivit të këtij aktvendimi duke ju referuar dispozitave nga neni 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i`a njohur shpenzimet kreditorit për përpilimin e propozimit për përmbartim përmes përfaqësuesit të autorizuar në shumën prej EUR 312.00, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifat e avokatëve.

Nga sa më sipër, bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3 të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 934/23, datë 13.06.2024

Gjyqtari

Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes Dhomave të Shkalës së Parë të kësaj Gjykate.